



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

V E N D I M

Nr. 155, Datë 25/10/2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 97, datë 08.08.2019, e znj. I. H., ku pretendohet për diskriminim për shkak të “*gjendjes familjare*”, “*gjendjes ekonomike*”, dhe “*përgjegjësisë prindërore*”, nga ana e Bashkisë Fier¹

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës së mësipërme, Komisioneri²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se në datën 05.03.2011, bashkëshorti i ankueses, Z. V. H. ka humbur jetën në krye të detyrës si polic i forcave të rendit, gjatë një konflikti ndërmjet tifozëve në Stadiumin “Loni Papuçiu”, Fier. Që prej vitit 2011, Znj. Hysi jeton dhe kujdeset e vetme për 3 fëmijët e saj, në mungesë të babait të tyre. Me Vendimin nr. 193, datë 25.03.2011, të Këshillit të Komunës Grecalli, Z. V. H. iu dha titulli “Nderi i Komunës” (pas vdekjes) me motivacion: “*Biri i fshatit Grecalli, prind e qytetar shembullor, me marëdhënie korrekte në komunitet, i përkushtuar në punë e detyrë për zgjidhjen e shmangien e konflikteve, u nda nga jeta në krye të detyrës si polic i forcave të rendit, krenari e komunitetit që e rrethonte*”. Njëkohësisht, me Vendimin nr. 40, datë

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KQSDA.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

29.05.2019, e Këshillit Bashkiak Fier u vendos ngritja e Memorialit, në kujtim të Z. V. H., si punonjës i forcave të rendit, i rënë në krye të detyrës. Ankuesja sqaron se deri me sot, ky vendim nuk është ekzekutuar nga Bashkia Fier. Znj. I. H. thekson faktin se i është drejtuar zyrtarisht Bashkisë Fier, ku kërkon informacion lidhur me çështjen e sipërpërmendur, por ky institucion nuk i ka kthyer përgjigje.

Për sa më sipër, ankuesja pretendon se diskriminohet nga Bashkia Fier, për shkak “*gjendjes familjare*”, “*gjendjes ekonomike*”, dhe “*përgjegjësisë prindërore*”, pasi është një grua e ve, e pa përkrahje, në gjendje të vështorë ekonomike, që jeton në një shtëpi më qera, me tre fëmijë të mitur, që kanë nevojë e kujdes të vazhdueshëm për të.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 97, datë 08.08.2019, e znj. I. H., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bashkisë Fier, me shkresën nr. 1234/1, datë 14.08.2019, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
 - 1.** Kopje e Vendimit nr. 40, datë 29.05.2015, të Këshillit Bashkiak Fier, nëpërmjet së cilit është vendosur ngritja e memorialit në nder të z. V. H.;
 - 2.** Informacion sqarues lidhur me mos ekzekutimin e Vendimit nr. 40, datë 29.05.2015, të Këshillit Bashkiak Fier;
 - 3.** Kopje të korrespondencës zyrtare me ankuesen, në lidhje me këtë çështje, ku të përfshihen kërkesat me shkrim të depozituara nga ankuesja dhe përgjigjet zyrtare të dërguara nga Bashkia Fier;

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “*Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër*”.

Shkresa e sipërpërmendur iu dërgua për dijeni edhe ankueses.

1. Në përgjigje të shkresës nr. 1234/1, datë 14.08.2019, të KMD-së, Bashkia Fier dërgoi shkresën nr. 7148, datë 23.08.2019, nëpërmjet së cilës informon si vijon:
 - Referuar çështjes së parë të parashtruar nga KMD, Bashkia Fier vë në dispozicion të tij, një kopje të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Fier nr. 40, datë 29.05.2015;
 - Në lidhje me çështjen e dytë të parashtruar nga KMD, sqarohet se Vendimi i Këshillit Fier, sikurse është përcaktuar në pikën 2 të tij, i ka dhënë efektet e tij, duke u zbatuar në atë periudhë kohore në bashkëpunim me familjarët, me vendosjen e pllakës së mermerit pranë vendit, ku i ndjeri V. H. ka humbur jetën;
 - Në lidhje me pikën e tretë, të parashtruar nga KMD, Bashkia Fier sqaron se në lidhje me korrespondencën zyrtare me ankuesen, Znj. I. H. ka depozituar një kërkesë lidhur me mirëmbajtjen e pllakës së mermerit të vendosur në zbatim të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Fier, në kuadër të realizimit të investimeve në objektet arsimore, kulturore dhe sportive të Bashkisë Fier. Për sa më sipër, Bashkia Fier sqaron se në ambientet e stadiumit “Loni Papuçiu” janë duke u realizuar investime sistemuese e rehabilituese, në përfundim të së cilave do të rishikohet konform procedurave administrative ligjore edhe kërkesa e qytetares I. H.
2. Në vijim të shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 97, datë 08.08.2019, e znj. I. H., mbështetur në Urdhërin nr. 174, datë 20.09.2019, të KMD-së, *“Për kryerjen e inspektimit pranë Bashkisë Fier, për verifikimin e pretendimeve të ankueses I. H.”*, në datën 01.10.2019, inspektorët e Komisionerit u paraqiten pranë Bashkisë Fier, të cilët morën informacionin e nevojshëm pranë Drejtorisë së Punëve Publike dhe Transportit, të këtij institucioni.

Sipas informacionit të administruar, rezultoi se në zbatim të Vendimit nr. 40, datë 29.05.2015, të Këshillit Bashkiak Fier, është ngritur memoriali i të ndjerit V. H., pranë vendit, ku i ndjeri kishte humbur jetën, përkatësisht në ambientet e Stadiumit “Loni Papuçiu”, Fier. Por, në kushtet kur, prej disa kohësh, në stadiumin “Loni Papuçiu” po kryheshin rikonstruksione, pllaka e mermerit, e cila ishte vendosur në ambientet e këtij stadiumi, ishte zhvendosur deri në përfundim të punimeve. Strukturat përkatëse të këtij institucioni sqaruan se në përfundim të rikonstruksionit, pllaka e mermerit do të rivendosej sërish në vendin e mëparshëm. Në vijim të inspektimit, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë Stadiumit “Loni Papuçiu”, ku kryen verifikimet

përkatëse. Nga verifikimet e kryera rezultoi se pranë këtij stadiumi po kryheshin punime dhe në ambientet e tij, nuk rezultonte të ishte e vendosur pllaka e mermerit, që simbolizonte Memorialin e ngritur për nder të z. V. H..

Inspektorët kërkuan gjithashtu të administronin informacion mbi faktin, nëse Bashkia Fier e kishte informuar ankuesen lidhur me sa më sipër, si dhe kërkuan të administronin një kopje të korrespondencës me ankuesen. Për sa më sipër rezultoi se ankuesja kishte depozituar pranë këtij institucioni kërkesën nr. 11834, datë 26.12.2018. Pas verifikimeve të kryera pranë Sektorit të Protokollit të Bashkisë Fier rezultoi se ky institucion nuk i ka kthyer përgjigje zyrtare kërkesës së ankueses. Në këtë kërkesë, Znj. I. H. kërkon marrjen e masave nga ana e Bashkisë Fier, për mirëmbajtjen e memorialit të bashkëshortit të saj.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 97, datë 08.08.2019, e znj. I. H., Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Në ankesën nr. 97, datë 08.08.2019, e znj. I. H., pretendohet për diskriminim për shkak të “*gjendjes familjare*”, “*gjendjes ekonomike*”, dhe “*përgjegjësisë prindërore*”, nga ana e Bashkisë Fier. Referuar akteve të depozituara në cilësinë e provës nga ankuesja dhe Bashkia Fier, rezulton se bashkëshorti i znj. I. H. ka qenë punonjës policie pranë Komisarariatit të Policisë Fier dhe ka humbur jetën në krye të detyrës në datën 05.03.2011, ora 15.30.

Mbështetur në vendimin nr. 62-2015-4029 (1254), datë 02.10.2015, e gjykatës së rrethit gjyqësor Fier rezulton se z. V. H., punonjës policie në shërbim, ka gjetur vdekjen në mënyrë të papritur në Stadiumin e futbollit “Loni Papuçiu”, Fier. Në referencë të aktit të ekspertimit mjeko-ligjor nr. 14, datë 05.03.2011 ka rezultuar se z. Hysi ka ndërruar jetë si pasojë e infarktit të miokardit. Nëpërmjet vendimit të sipërpërmendur, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur vërtetimin e faktit juridik të humbjes së jetës së të ndjerit V. P. H., punonjës policie në Komisariatin e Policisë Fier, në krye të detyrës për ruajtjen e rendit në stadiumin “Loni Papuçiu” Fier, në datën 05.03.2011, ora 15.30.

Organet e pushtetit vendor i kanë akorduar nderin dhe respektin e duhur Z. V. H., me vendime të veçanta. Me Vendimin nr. 193, datë 25.03.2011, e Këshillit të ish-Komunës Greçalli, shtetasit V. H. iu dha titulli “Nderi i Komunës” (pas vdekjes) me motivacion: *“Biri i fshatit Greçalli, prind e qytetar shembullor, me marëdhënie korrekte në komunitet, i përkushtuar në punë e detyrë për zgjidhjen e shmangien e konflikteve, u nda nga jeta në krye të detyrës si polic i forcave të rendit, krenari e komunitetit që e rrethonte”*.

Në vijim, me Vendimin nr. 40, datë 29.05.2015, e Këshillit Bashkiak Fier, *“Për ngritjen e memorialit në stadiumin “Loni Papuçiu”*, është vendosur ngritja e një memoriali për të ndjerin V. H., në vendin, ku ai kishte humbur jetën. Vendimi nr. 40, datë 29.05.2015, i Këshillit Bashkiak Fier përcakton shprehimisht: *“1. Miratimin e ngritjes së një memoriali në kujtim të policit të vrarë në krye të detyrës në Stadiumin “Loni Papuçiu”. 2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi i Bashkisë Fier në bashkëpunim me familjarët”. 3. Vendimi shpallet në dt. 29/05/2015. 4. Vendimi hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.”* Referuar pjesës hyrëse të vendimit të mësipërm, rezulton se memoriali do të ngrihej me kontributet e Znj. I. H..

Për sa më sipër, Znj. I. H. pretendon se Bashkia Fier nuk e ka ekzekutuar Vendimin nr. 40, datë 29.05.2015, e Këshillit Bashkiak Fier. Ndërkohë që, gjatë shqyrtimit administrativ, rezultoi se Vendimi i sipërpërmendur është ekzekutuar nga Bashkia Fier në vitin 2015 dhe në vendin ku z. V. H. ka humbur jetën, ka qenë vendosur një pllakë mermeri, në cilësinë e një Memoriali në kujtim të tij. Në kushtet kur, ambientet e Stadiumit “Loni Papuçiu” po rikonstruktohen, memoriali ishte zhvendosur përkohësisht, për efekt të punimeve, që po zhvilloheshin në këtë stadium.

Fakti që, memoriali për Z. V. H. ishte vendosur në ambientet e Stadiumit “Loni Papuçiu” pranohet edhe nga vetë ankuesja, në kërkesën e saj nr. 11834, datë 26.12.2018, drejtuar Bashkisë Fier, ku citohet: *“Me vendimin nr. 40, datë 29.05.2015, të Këshillit Bashkiak Fier është miratuar ngritja e një memoriali në kujtim të policit të vrarë në krye të detyrës në Stadiumin “Loni Papuçiu”. Pra në kujtim të bashkëshortit tim V. H.. Memorial i cili nuk është realizuar konform procedurave administrative, ndonëse figuron me një pllakë mermeri pranë vendit ku bashkëshorti im ka humbur jetën....”*. Në kërkesën e sipërpërmendur, rezulton se ankuesja nuk kërkon ngritjen e memorialit për bashkëshortin e saj, nga ana e Bashkisë Fier, por kërkon mirëmbajtjen e tij. Nga hetimi administrativ rezultoi se kërkesa nr. 11834, datë 26.12.2018 e znj. Hysi nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e ankesës së depozituar pranë Komsionierit. Pavarësisht këtij fakti, Komisioneri çmon se Bashkia Fier, në zbatim të dispozitave ligjore të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, duket ta kishte informuar Znj. I. H. mbi çështjen e parashtruar nga ana e saj në këtë kërkesë.

Për sa më sipër, neni 20, pika 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikon: *1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”*

Në zbatim të Vendimit nr. 40, datë 29.05.2015 e Këshillit Bashkiak Fier, memoriali i të ndjerit V. H. është ngritur në ambientet e stadiumit “Loni Papuçiu”, Fier. Në këtë kontekst, vendimi i sipërpërmendur i Këshillit Bashkiak Fier konsiderohet i ekzekutuar. Zhvendosja e këtij memoriali është e përkohëshme, deri në momentin e përfundimit të rikonstruksionit të stadiumit. Në këtë kontekst, KMD gjykon se znj. I. H. nuk i është refuzuar ofrimi i shërbimit nga ana e Bashkisë Fier.

Referuar nenit 3, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, diskriminimi përkufizohet si: *“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”*

Referuar në parashikimin e mësipërm, si dhe në interpretim të pikës 1, të nenit 7 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet: *1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”,* Komisioneri gjykon se znj. I. H. nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, disfavorizues nga Bashkisë Fier.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të znj. I. H., për shkaqet e pretenduara në ankesë, nga Bashkia Fier.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha - të mira dhe shërbime

Shkak - *“gjendja familjare”, “gjendja ekonomike”, dhe “përgjegjësia prindërore”*